



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS**

NJOFTIM PËR MEDIAT

Tiranë, më 12.01.2017

Mbi monitorimin e Tregut të Gazit të Lëngshëm për konsum familjar dhe biznesin

Autoriteti i Konkurrencës, pas shqetësimit të ngritur nga mediat elektronike dhe të shkruara në lidhje me rritjen e çmimit të gazit të lëngshëm në treg, i cili në ndryshimet e fundit ligjore për paketën fiskale, ka prekur vetëm përdorimin e gazit të lëngshëm për automjetet, dhe jo përdorimin e tij për nevoja të konsumatorit (rritja e akcizës për këtë kategori është 0 lekë), ka nxjerrë në terren me urgjencë specialistët për monitorimin e tregut sipas nenit 28 të Ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti i Konkurrencës do të vlerësojë kushtet e tregut për të parë nëse ka shenja të ndonjë marrëveshje të ndaluar (kartel) apo abuzim me pozitën dominuese, e cila mund të sjellë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës nëpërmjet vendosjes në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të çmimit të blerjes apo të shitjes, ose të ndonjë kushti tjetër tregtimi, i cili ndikon në mënyrë të drejtpërdrejte tek konsumatori.

Tregu përkatës nën monitorim do të jetë tregu i importit dhe tregtimit më shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm për konsum familjar, dhe për bizneset të cilat e përdorin si lëndë djegëse në ofrimin e prodhimit dhe shërbimeve të tyre kundrejt konsumatorit.

Pas monitorimit dhe vlerësimit të situatës nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës Autoriteti do të procedojë menjëherë me marrjen e masave konkrete, ndaj subjekteve të tregtimit me shumicë ose pakicë për kthimin e tregut në kushtet e konkurrencës.